



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

CM. 3219/1 Prot

D. 13.06.22



Nr. 368/1 prot.

Shkodër, më 8.06.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 34, datë 26.05.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, të ligjit nr. 9693, dt. 19.03.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, neni 15, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 632, datë 11.06.2019 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, të shkreses së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 3214 prot., datë 01.06.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 26.05.2022”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 34, datë 26.05.2022 “Për rishikimin e VKB nr. 10, datë 25.02.2022 “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit kullotë të gatshme për dhënie në përdorim”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T


Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
KESHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr 34 Datë 26.05, 2022

Për rishikimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 10, datë 25.02.2022, “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë” të gatshme për dhënie në përdorim”.

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, neni 9, pika 1.2, ligji nr 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011 Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 68, datë 28.01.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodres”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, ligjit nr 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullësor”, i ndryshuar, neni 17 “Për përdorimin e sipërfaqes dhe të tokës fond kullësor”, shkresën nr 164/1 prot, datë 15.03.2022, “Mbi vendimin nr 10, datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, ardhur nga Prefekti i Qarkut Shkodër, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit nr 3 datë 09.05.2022, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit, ku propozohet Rishikim i Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 10, datë 25.02.2022, “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë” të gatshme për dhënie në përdorim”. Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

1. Dhënie e pëlqimit për rishikimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 10, datë 25.02.2022 “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë” të gatshme për dhënie në përdorim”, duke përcaktuar saktë pasuritë e llojit “Kullotë”, të pasqyruara në fletët e inventarit bashkëlidhur, dhe që janë të renditura përkatësisht në numrat rendor duke filluar nga numri 784-830, dhe nga numri rendor 833-879.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01.06, 2022